



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
V E N D I M
K.P.P. 654/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.09.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave datë 26.07.2017 mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Diezela” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozimë”, me Nr. REF-19916-07-07-2017, me objekt “Blerje naftë për nevojat e Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2017”, me fond limit 4,815,833 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.07.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

Ankimues: “Diezela” shpk
Ruga “Kavajës”, Qendra e Biznesit “Gurten”, zyra 209.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fushë-Arrëz

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.07.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozimë”, me Nr. REF-19916-07-07-2017, me objekt “Blerje nafte për nevojat e Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2017”, me fond limit 4,815,833 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.07.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

II.2. Në datën 21.07.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 26.07.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “Oruçi” shpk	9.7 %	I skualifikuar
- “Diezela” shpk	15 %	I skualifikuar

II.4. Në datën 31.07.2017 me operatori ekonomik “Diezela” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO për skualifikimin e tij me argumentat si më poshtë:

Së pari: *Theksojmë që marrëveshja ndërmjetë të dy subjekteve është origjinale me firmën e administratorëve dhe vulat e kompanive, dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme që të noterizohet.*

Së dyti: *Faturat tatimore janë dokument ekstra të paraqitura duke qënë se në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.1 nuk kërkoheshin. Faturat tatimore janë kopje të dyta dhe këto nuk vulozen nga shitësi por duhen të jenë detyrimisht të firmosura nga shitësi, blerësi dhe transportuesi. Në këtë rast faturat janë kopjet e dyta origjinale të firmosura nga të gjitha palët.*

Së treti: Në kriteret e përgjithshme të kualifikimit sipas dokumentave standarte për tender shtojca 7, pika 2.b “ kërkohet një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të lëshuara nga Administrata Tatimore vërtetohet përmes dokumentave të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës. Theksojmë se subjekti e ka dorëzuar e ka dorëzuar dokumentin konformë kërkesave tuaja brënda tre muajve (12.06.2017) nga data e hapjes së ofertave.

Sa më sipër kërkojmë nga KVO-ja të rishikohen edhe njëherë dokumentat e Operatorëve Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë pasi mendojmë se nuk është ruajtur i njëjti standart vlerësimi për të gjithë operatorët që kanë konkuruar në këtë procedurë.

II.5. Në datën 08.08.2017, me shkresën nr. 1097 prot operatori ekonomik ankimues “Diezela” sh.p.k, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktorë për skualifikimin e tij nga kjo procedurë objekt ankimi.

II.6. Në datën 10.08.2017, me shkresën nr. 1369 prot, operatori ekonomik ankimues “Diezela” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me skualifikimin e tij nga autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1958 prot., datë 16.08.2017, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1369/2 prot, datë 18.08.2017, me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Diezela” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Marrveshja furnizimit ndërmjet subjektit “Diezela” shpk dhe subjektit “Kurti” shpk është e panoterizuar. Faturat tatimore të shitjes mes shoqërisë “Kurti” shpk dhe “Diezela” shpk nuk janë të vulosura nga shitësi”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik dhe financiar”, pika 2.1 të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

[...]

Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën: Kontrata te ngjashme sipas objektit te prokurimit (furnizim me karburant), te realizuara ne dy vitet e fundit, me nje vlere 40% e fondit limit te prokurimit. Per kete duhet te paraqitet:

- *Dokumenti i Kontrates per furnizimin e ngjashem, shoqeruar me Vertetim nga Autoriteti Kontraktor, ku te specifikohet sasia dhe vlere perkatese e furnizuar. [...]*

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike në drejtim të disponueshmërisë të kriterit sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur:

- i. Akt Marrveshje Furnizimi e datës 11.01.2016, midis palëve “Diezel”a shpk dhe “Kurti” shpk me objekt “Furnizimi me karburant të llojit Gazoil < 10 ppm”, nga shitësi tek blerësi sipas kushteve të përcaktuara në Aktmarrveshjen e Furnizimit.[...]
- ii. Vërtetim realizimi me Nr 1601/17 Prot, datë 16.01.2017.
- iii. Fatura Tatimore Shitje me Nr.29, datë 18.01.2016, sasia 4000 litra, vlera 516.666 lekë pa tvsh.
- iv. Fatura Tatimore Shitje me Nr. 119, datë 12.05.2016, sasia 4000 litra, vlera 516.666 lekë pa tvsh.
- v. Fatura Tatimore Shitje me Nr. 208, datë 25.08.2016, sasia 5040 litra, vlera 659.400 lekë pa tvsh
- vi. Fatura Tatimore Shitje me Nr. 322, datë 10.12.2016, sasia 6000 litra, vlera 815.000 lekë pa tvsh.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.5. Në nenin 27 pika 4 “Kantarat e Mallrave” të VKM nr.914, datë, 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: 1. “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”. 2. “Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”. 3. “Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”.

III.1.6. Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm,

gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se operatori ekonomik "Diezela" shpk. rezulton se operatori ekonomik e ka përmbushur kriterin e sipercituar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik "Diezela" sh.p.k. plotësojnë kërkesën e autoritetit kontraktor për eksperiencat e ngjashme të realizuara më parë, pasi është e njëjtë me objektin e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktor në procesin e shqyrtimit të kontratave të paraqitura për eksperiencat të ngjashme të mëparshme duhet të fokusohet jo vetëm në titullin, objektin apo llojin aktmarrvëshjes apo kontratës së ngjashme por duhet të analizojë të gjithë komponentët e përmbajtjes së aktit të paraqitura, për të verifikuar dhe konkluduar më pas në kryerjen ose jo të zërave të ngjashëm në kontratat e realizuara më parë. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të pretendojë se lidhja e një aktmarrvëshjeje midis dy subjekteve juridike (private) është e pavlefshme për faktin se nuk është e noterizuar, për sa kohë këto subjekti kanë shprehur vullnetin e tyre të lirë për të lidhur një marrvëshjeje midis tyre duke përcaktuar objektin, të drejtat dhe detyrimet e tyre do të konsiderohet e vlefshme. Po kështu referuar nenit 27 pika 4 "Kantarat e Mallrave" të VKM nr.914, datë, 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku parashikohen dëshmitë që duhet të dorëzojnë operatorët me qëllim që të vërtetojnë se i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, përcaktohet shprehimisht "Dëshmitë për furnizimin e mallrave duhet të jepen përmes vërtetimeve të marrësit të mallit ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara...".

Sa më sipër KPP, konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik, rezulton se aktmarrvëshja e furnizimit e nënshkruar më datë 11.01.2013, është shoqëruar me faturën tatimore përkatëse të shitjes ku janë përcaktuar qartë elementët e kërkuar në nenin 27, pika 4 të VKM nr.914, datë, 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si: data, vleftha, sasia e mallrave të furnizuara dhe emri i nënshkrimit të personit blerës dhe shitës.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ankimuesi e ka përmbushur kriterin e kualifikimit duke vërtetuar kështu se disponon kapacitetet në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Diezela" sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "Mungojnë në listpagesat për kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetsore për muajin Maj dhe Qershor 2017", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1 Në shtojcën 7 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", pika 2.2 të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

[...]

- Vërtetim për shlyerjen e taksave lokale 2017 pranë njësisve vendore ku është i rregjistruar.
- Xhiroja mesatare vjetore gjatë 2 viteve të fundit, duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se fondi limit që prokurohet. [...]

III.2.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike në drejtim të disponueshmërisë të kriterit sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur:

- Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore lëshuar nga Bashkia Vore me Nr. 198 prot, datë 29.05.2017.
- Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore lëshuar nga Bashkia Tiranë me Nr. 132069/1 prot, datë 09.06.2017.
- Vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit dhe Rregjistrimit të Tatimpaguesve Tiranë me Nr 33125/1 prot, datë 12.06.2017, me anë të të cilit vërtetohet situata financiare e vitetve 2014-2015-2016, vite për të cilat subjekti ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.2.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.2.5. Në nenin 27 pika 5 “Kantarat e Mallrave” të VKM nr.914, datë, 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon”:

- a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose
- b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet;

III.2.6 Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike,

profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter tjetër i cili nuk është i përfshirë në kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “*Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese*” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

III.2.8. Nisur nga argumentat e ankimesit në ankesë, si dhe referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të Shtojcës 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pika 2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk konstaton asnjë kriter i cili të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës paraqitjen e një dokumenti si “*listpagesat për kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetsore për muajin Maj dhe Qershor 2017*”. Komisioni në këtë kuptim gjykon se operatori ekonomik “Diezela” shpk nuk gjëndet përballë mosplotësimit të ndonjë kriteri kualifikimi sa kohë që në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk kërkohen dokumentat që autoriteti kontraktor pretendon se nuk janë paraqitur. Paraqitja e dokumentave shtesë nga ana e operatorëve ekonomik nuk mund të përbëjë shkak penalizimi ndaj tyre pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin e duhura për realizimin me sukses të kontratës.

Pra sa më spër gjykojmë se pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Diezela” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me Nr. REF-19916-07-07-2017, me objekt “Blerje nafte për nevojat e Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2017”, me fond limit 4,815,833 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.07.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Diezela” shpk duke e kualifikuar atë.

3. Autoriteti kontraktor, brënda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Diezela” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1369 Protokoli, Datë 10.08.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

